



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1634/1 Prot.

Tiranë, më 25 / 10 / 2019

V E N D I M

Nr. 152, Datë 25 / 10 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 96, datë 08.08.2019, të bërë nga I.H¹ kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier (DRSSH Fier), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes familjare” dhe “përgjegjësisë prindërore²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, I.H në mes të tjerash informon se: *“Diskriminimi i saj nga DRSSH Fier ka filluar që në momentin e daljes së pensionit familjar në vitin 2011 e më pas me daljen e pensionit suplementar me vlerën qesharake 2211 lekë. Në këtë moment kanë filluar dhe mosmarrëveshjet e saj me DRSSH Fier, ku me shkresën/ankesë nr.427, datë 20.02.2012 ka kundërshtuar masën e pensionit suplementar e cila binte në kundërshtim me faktin e rënies në krye të detyrës të bashkëshortit të saj edhe pse ishte një fakt publik, i vërtetuar nga Prokuroria Fier dhe Prokuroria e Përgjithshme. Për këtë arsye asaj iu desh të vërtetonte faktin e rënies në krye të detyrës, në gjykatë. Në lidhje me llogaritjet e bëra nga DRSSH Fier për përfitimet që i takojnë familjes së saj, I.H shprehet se, pas ankesave të shumta të bëra për mënyrën e llogaritjes së pensionit suplementar familjar, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH Tiranë dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë (Vendimi nr.81, datë*

¹ Subjekti ankues është bashkëshortja e policit V.H, të rënë në krye të detyrës në datë 05.03.2011.

² Referuar Çertifikatës Familjare, datë 03.08.2019, I.H është kryefamiljare, nënë e tre fëmijëve.

24.01.2017) janë evidentuar llogaritje të gabuara të përfitimeve nga ana e DRSSH Fier. Me hyrjen në fuqi të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i është ulur grada nga Kryeinspektor në Inspektor, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në të ardhurat e familjes së saj në pensionin suplementar. Po sipas këtij ligji, llogaritjet duhej të kryeheshin në bazë të pagesës bruto e jo neto, pasi DRSSH Fier punon sipas 2 standarteve, disa në bruto dhe disa në neto, por edhe pse llogaritet sipas pagës neto, përsëri jemi në kushtet kur pensioni suplementar po përfitohet në mënyrë të gabuar në llogaritjet e tij, pasi sipas nenit 24 të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, përfitimet vendosen në vlerën e 100% të pagës sa herë kjo e fundit ndryshon sipas gradës, përfitimet vendosen në pensionin suplementar pasi nuk indeksohet sa herë indeksohet pensioni familjar, por shtohet sa herë shtohet paga dhe jo të zbritet pensioni familjar, i cili ka përfitime sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndërkohë nga DRSSH Fier sa herë ndryshon paga zbatohet vetëm llogaritja sipas nenit 21, dispozitë që zbatohet vetëm në momentin që lind e drejta e pensionit suplementar, pra në momentin e rënies në krye të detyrës. Në këto kushte nga ana e institucionit të DRSSH Fier jam diskriminuar si person pa mbështetje, kryefamiljare e vetme duke u përcjellë me fjalë fyese, “Ik ankohu ku të duash, nuk pyesim ne”, “Rri urtë, se ta ulëm edhe këtë vlerë që merr”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 96, datë 08.08.2019 të I.H u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1233/1, datë 14.08.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier për ankesën e bërë nga I.H si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të ankesave të I.H, drejtuar DRSSH Fier dhe ISSH-së dhe përgjigjeve të marra nga këto institucione që nga viti 2012 e në vijim.
 - Shpjegime nëse ka patur raste të njëjta apo të ngjashme të llogaritjes së pensionit familjar dhe suplementar për shtetas të tjerë, dhe nëse po, kopje të dokumenteve të këtyre dosjeve.

Me shkresën nr. 6468/1, datë 22.08.2019, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier në mes të tjerash informoi se: *“Në mbështetje të nenit 19 dhe 20 të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.....”, të ndryshuar, fëmijëve të të ndjerit, i është caktuar pension suplementar familjar, me vendim caktim pensioni të DRSSH Fier nr.464, datë 31.01.2012, me datë fillim pensioni 23.03.2011 e në vazhdim. Në bazë të nenit 24 “Indeksimi” pika 1, të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, përfitimi është indeksuar sa herë janë indeksuar dhe pensionet e caktuara sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R.SH”, të ndryshuar. Me ndryshimin e pagës nga Drejtoria e Policisë së Shtetit do ndryshohet dhe masa e pensionit familjar suplementar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Me shkresën nr.4176/1, datë 10.06.2019, DRSSH Fier ka kërkuar nga ISSH Tiranë auditimin e ligjshmërisë dhe kontroll financiar të dosjes së përfitimit, e cila me shkresë nr.4311/3, datë 27.06.2019, ka kthyer dosjen nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Me DRSSH Fier, subjekti ankues ka zhvilluar procesin gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me objekt “Detyrimin e palës së paditur DRSSH të paguajë pension suplementar familjar të barabartë me pagën referuese të punonjësit (100% të pagës) që në çastin e lindjes së të drejtës, që është data 05.03.2011. Detyrimin e palës së paditur të rillogarisë masën e përfitimit për efekt të përlllogaritjes së gabuar të pensionit suplementar familjarë për periudhën nga 05.03.2011 deri në ekzekutimin e vendimit. Detyrimin e palës së paditur DRSSH ti paguajë paditëses kamatë vonesat për pagesën e pakryer në shumën 2.472.500 lekë, për shkak të përlllogaritjes së gabuar apo të mosllogaritjes së pensionit suplementar familjarë që nga data 05.03.2011 e deri më sot. Shpenzimet gjyqësore dhe*

ato të përfaqësimit me avokat në ngarkim të palës së paditur”. Për vendimin gjendemi ende në proces në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, nr. Çështje 31018-01988-8602917, pasi është ankimuar nga të dy palët në proces. I.H është paraqitur disa herë personalisht në DRSSH Fier ku është pritur nga specialistët dhe titullari dhe ka marrë sqarimet e nevojshme në lidhje me veprimet në dosjen e pensionit. Gjithashtu, për çdo ankesë me shkrim drejtuar DRSSH-së apo ISSH-së ka marrë përgjigje me shkrim”.

Me shkresën nr. 4311/7, datë 29.08.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore e ka njohur Komisionerin, me të gjithë historikun e përfitimit të pensionit suplementar të I.H si dhe ka vënë në dispozicion, korrespondencën që ka pasur me subjektin ankues.

- Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 166, datë 16.09.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në DRSSH Fier”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë DRSSH-së Fier në datë 25.09.2019, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-s, morën takim me A.O, me detyrë Drejtor i DRSSH Fier, dhe punonjëset, F.M, A.K, H.Z dhe A.T.

Gjatë inspektimit, Drejtori i DRSSH Fier, lidhur me verifikimin e ngjarjeve të ndodhura për pretendimin për përdorimin e gjuhës fyese nga ana e punonjësve të DRSSH Fier, informoi se sistemi i sigurisë së institucionit është në varësi të kompanisë së sigurisë. Kamerat e sigurisë janë të vendosura në mjedise të përbashkëta, janë vetëm video dhe pamjet ruhen deri në 30 ditë. Ngjarjet e pretenduara kanë ndodhur rreth muajit Qershor 2019 dhe relativisht është e pamundur të verifikohen pretendimet e ankueses sepse nuk ka pamje video dhe audio dhe ngjarjet kanë ndodhur brenda mjediseve të zyrës. Lidhur me verifikimin/auditimin e dosjes së I.H të bërë nga ISSH në periudhën Qershor 2019, A.O informoi se dosja është inspektuar/audituar nga Njësia e Inspektim/Përfitimit në ISSH, dhe nuk është konstatuar parregullsi. Lidhur me pretendimin për llogaritje të gabuar të përfitimeve, A.O informoi se janë në proces gjyqësor për këtë çështje dhe do jetë gjykata që do të vendosë për llogaritjet e sakta apo jo.

Lidhur me përdorimin e gjuhës fyese, punonjësja F.M deklaroi se që nga viti 2016 nuk e ka takuar asnjëherë apo të ketë shkëmbyer fjalë me I.H.

Gjatë inspektimit, punonjësja A.K informoi se: “*Rreth datës 28.05.2019, I.H është paraqitur në zyrë dhe ka kërkuar informacion për rritjen e pensionit sipas indeksit të muajit Prill 2019. Ajo është munduar që ti shpjegojë vendimin e indeksimit, pa përdorur asnjë fjalë jashtë etikës por ankuesja është revoltuar dhe është larguar duke përplasur derën. Deklarata e A.K u konfirmua dhe nga punonjëset H.Z dhe A.T të cilat kishin qenë prezent në zyrë. Lidhur me krahasimin e llogaritjes së pensionit të ankueses dhe të përfituesit K.D, punonjësja A.K informoi se të dy dosjet janë trajtuar njësoj, por masa e përfitimit të K.D është më e madhe sepse është paga më e lartë dhe masa e pagës ka ardhur nga Ministria e Mbrojtjes dhe nuk bëhen ndryshime nga punonjësit e DRSSH Fier. Lidhur me llogaritjen e pensionit të përfituesit M.B, punonjësja A.K*

informoi se nuk janë dosje të njëjta, sepse M.B trajtohet me pension familjar dhe pension me Dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. 758, datë 01.02.1994 dhe çdo vit këto dosje përfitojnë rritje sipas VKM-së për rritjen e përgjithshme të pensioneve, ndërsa I.H trajtohet me pension familjar dhe pension suplementar familjar që ndryshon sipas Ligjit 10142/2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.....”, të ndryshuar dhe ndryshon sa herë që ndryshon paga e punonjësve të policisë”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për masën e llogaritjes së pensionit suplementar familjar nga ana e DRSSH Fier.

Në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet procedura e ankimit kundër vendimeve të DRSSH-ve. Në nenin 86 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; 2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore; 3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar; 4. Këshilli Administrativ përcakton përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Komisionit të Ankimit”.

Bazuar në dokumentet e administruara nga KMD, rezulton se subjekti ankues duke mos rënë dakord me vendimmarrjet e DRSSH-së dhe ISSH-së, në datë 09.08.2016 i është drejtuar me Kërkesë Padi, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, kundër DRSSH Fier, në të cilën ka kërkuar: 1. Detyrimin e palës së paditur DRSSH të paguaj pension suplementar familjar të barabartë me pagën referuese të punonjësit (100% të pagës) që në çastin e lindjes së të drejtës, që është data 05.03.2011. 2. Detyrimin e palës së paditur të rillogarisë masën e përfitimit për efekt të përlllogaritjes së gabuar të pensionit suplementar familjarë për periudhën nga 05.03.2011 deri në ekzekutimin e vendimit. 3. Detyrimin e palës së paditur DRSSH ti paguajë paditëses kamatë vonesat për pagesën e pakryer në shumën 2.472.500 lekë, për shkak të përlllogaritjes së gabuar apo të mos llogaritjes së pensionit suplementar familjar që nga data 05.03.2011 e deri më sot. 4. Shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit me avokat në ngarkim të palës së paditur.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me Vendimin nr. 81, datë 24.01.2017 ka vendosur: 1. Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë. 2. Detyrimin e palës së paditur DRSSH Fier ti paguajë paditëses I.H pension suplementar familjar prej datës 05.03.2011 që i ka lindur e drejta deri në datën 31.10.2015 shumën prej 1.591.959 lekë. 3. Rrezimin për pjesën tjetër të padisë.

Vendimi nuk ka marrë formë të prerë pasi të dyja palët kanë ankimuar vendimin dhe çështja po shqyrtohet në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë (Çështje nr. 31018-01988-8602917).

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr.10221/04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nuk është shprehur për ato pretendime që ankuesja i ka bërë njëherësh edhe objekt të shqyrtimit gjyqësor, duke vlerësuar se janë gjë e gjykuar.

B. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses nga DRSSH Fier.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Mbështetur në nenet 19 dhe 20 të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.....”, të ndryshuar, fëmijëve të I.H i është caktuar pension suplementar familjar, me disa vendime në vazhdimësi nga ana e DRSSH Fier. Bazuar të nenit 24/1 “Indeksi” të ligjit të sipërcituar, përfitimi i pensionit suplementar është indeksuar sa herë janë indeksuar dhe pensionet e caktuara sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R.SH”, të ndryshuar.

Bazuar në legjislacionin e sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgon pranë DRSSH-ve dokumentet për rillogaritje pensioni familjar për ish-punonjësit e Policisë të vrarë në krye të detyrës, në rastin në fjalë ka dërguar, Modelarin nr.02, Vërtetim nr.9131/2, datë 14.06.2017 “Për pagën referuese neto për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare”. Referuar shkresës nr. 3/1103-1, datë 25.06.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për rastin e I.H, modelari nr.02 i fundit ka qenë ai i datës 14.06.2017, dhe nga ajo periudhë nuk ka pasur ndryshime të pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit. Në këtë modelar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit janë përcaktuar, paga bruto dhe neto. Referuar këtyre elementëve nga ana e DRSSH Fier është bërë llogaritja e masës së pensionit suplementar familjar për fëmijët e I.H.

Referuar dokumentacionit të administruar nga KMD, vërtetohet se dhe në rastin e shqyrtimit të dosjes së ushtarakut B.H, vrarë për shkak të detyrës, të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nga ana e DRSSH Fier janë bërë llogaritjet e përfitimit të pensionit suplementar familjar në të njëjtën mënyrë, siç është bërë për rastin e I.H duke iu referuar Modelarit nr. 02 të vitit 2017.

Gjithashtu dhe në rastin e vlerësimit të dosjes së ushtarakut K.K, vrarë për shkak të detyrës, të dërguar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, nga ana e DRSSH Fier janë bërë llogaritjet e përfitimit të pensionit suplementar familjar, me të njëjtën metodologji siç ishte bërë dhe në rastin e I.H duke iu referuar Modelarit nr. 02 të vitit 2017.

Gjithashtu, referuar pretendimeve të subjektit ankues për llogaritje të ndryshme të masës së pensionit suplementar familjar, krahasuar me përfituesin M.B, Komisioneri në vlerësim të deklaratave dhe dokumenteve të administruara gjatë inspektimit të datës 25.09.2019, vlerëson se familjarët e të ndjerit M.B trajtohen sipas kriterëve ligjore të parashikuara me Dekretin nr. 758, datë 01.02.1994, të Presidentit “Për mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me Ligjin nr.

7799, datë 24.02.1994. Pra, dy rastet nuk janë në kushte të trajtimit të barabartë nga ana e legjislacionit në fuqi, që të mund të merret në konsideratë, për efekt krahasimor elementi “gjendja ekonomike”, “gjendja familjare” dhe “përgjegjësia prindërore”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk ka tagër të gjykojë mbi masën e llogaritjes së pensionit suplementar familjar, por mbështetur në atributet që i jep Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mund të kryejë konstatim, nëse ankuesja i është nënshtruar apo ekspozuar një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues apo të pabarabartë, nga ana e DRSHS Fier, në krahasim me përfitues të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në kuptim të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.

Mbështetur në analizimin e fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e trajtimit të pabarabartë të ankueses, në krahasim me përfituesit e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme, me të, nga ana e DRSSH Fier.

Për sa më sipër, në mungesë të trajtimit të pabarabartë të ankueses nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkaqet e pretenduara nga I.H, nga ana e DRSSH Fier.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues për përdorimin e gjuhës fyese nga ana e punonjëseve F.M dhe A.K, Komisioneri vlerëson se nuk u arrit që të disponoheshin fakte dhe prova për të vërtetuar këto pretendime.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases I.H nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier për shkak të gjendjes ekonomike, gjendjes familjare dhe përgjegjësisë prindërore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONER